VENDIM
Nr. 5, Datë 27.12.2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 2, DATË 10.3.2010 "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË ADMINISTRIMIT TË REGJISTRIMIT TË TË DHËNAVE, TË HEDHJES SË TË DHËNAVE, TË PËRPUNIMIT DHE NXJERRJES SË TYRE"

Mbështetur në pikën 6 të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar,

VENDOSA:

Në vendimin nr. 2, datë 10.3.2010 "Për përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre", bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijojnë:

1. Pas titullit të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale", shtohet togfjalëshi si vijon:

"i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012."

2. Përmbajtja e shkronjës "a" të pikës 1 të kreut I, ndryshohet si më poshtë:

"Të dhënat mund të mbahen vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë e legjitime, dhe përpunimi i tyre duhet të bëhet vetëm mbi bazën e këtyre qëllimeve".

3. Paragrafi "vi" i shkronjës "a" të pikës 4, në kreun I, shfuqizohet.

4. Titulli i pikës 6 të kreut I ndryshohet si vijon:

"Transferimi ndërkombëtar i të dhënave".

5. Në shkronjën "a" të pikës 6, të kreut I, fjala "tipi" zëvendësohet me fjalën "kategoria".

6. Në përmbajtje të këtij vendimi, termi "subjekt kontrollues" zëvendësohet me termin "kontrollues".

7. Në pikën 2 të kreut II, bëhen këto ndryshime:

a) Përmbajtja e shkronjës "b" ndryshohet si vijon:

"Fushën dhe qëllimin për të cilin mblidhen dhe do të përpunohen të dhënat personale".

b) Shkronja "c" shfuqizohet.

c) Në shkronjën "d", fjala "zbulohen" zëvendësohet me fjalën "përhapen".

ç) Përmbajtja e shkronjës "e" ndryshohet si vijon:

"Të drejtën për askes, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij".

d) Shkronjat "f", "g" dhe "h" shfuqizohen.

dh) Në fund, shtohen shkronjat me përmbajtje si vijojnë:

- Mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni;

- Faktin nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare;

- Faktin nëse është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor;

- Pasojat e refuzimit të dhënies së të dhënave.

8. Përmbajtja e pikës 2 të kreut III, ndryshohet si vijon:

"Të dhënat mund të përpunohen pa pëlqimin e subjektit kur përpunimi është i nevojshëm për një nga arsyet e parashikuara në pikën 1 të nenit 6 të ligjit, me përjashtim të shkronjës "a"."

9. Titulli i kreut V ndryshohet në "Konfidencialiteti i të dhënave" dhe përmbajtja e tij ndryshohet si vijon:

"Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat e punësuar prej tyre, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave personale që përpunojnë, në përputhje me detyrimet e parashikuara në nenin 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar."

10. Moszbatimi i kërkesave të këtij vendimi, përbën shkelje të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE
Flora Çabej (Pogaçe)